

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE, MAJ 2025

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	30.4.2025	Kërkohet informacion për paketën e maleve.	2.5.2025	Deleguar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.	Deleguar	Nuk ka
2	1.5.2025	Kërkohet vendimi nr. 393, datë 3.9.1992, i Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.	2.5.2025	Deleguar Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.	Deleguar	Nuk ka
3	6.5.2025	Kërkohen procesverbalet e mbledhjeve të qeverisë në datat, 17 prill, 24 prill, 30 prill si dhe lista e anëtarëve që kanë marrë pjesë për secilën mbledhje.	6.5.2025	Informohet se referuar ligjit nr. 9000 datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” neni 17, pika 2, “Vlerësimet, debatet dhe raportimet mbeten konfidenciale”, nuk mund t’i vendoset në dispozicion, informacioni i kërkuar.	Përfunduar	Nuk ka
4	8.5.2025	Gjatë shqyrtimit të disa materjaleve kanë lidur disa pyetje, për të cilat kërkohet komenti ynë, për të qenë sa më pranë raportimit të saktë dhe sa më pranë së vërtetës.	9.5.2025	Informohet se bazuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkesa për informacion duhet t’i referohet një dokumenti nëpërmjet të cilit kërkohet informacion, psh, strategji, ligj, VKM, Urdhër, Udhëzim etj, sepse ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, informacione, për t’ju përgjigjur pyetjeve, për të bërë komente etj.	Përfunduar	Nuk ka
5	12.5.2025	Kërkohet informacion për paketën e maleve.	13.5.2025	Deleguar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.	Deleguar	Nuk ka
6	20.5.2025	Kërkohet një kopje të plotë të marrëveshjes së bashkëpunimit apo koncesionit të firmosur për projektin e zhvillimit të portit të Durrësit. • A ekziston një studim fizibiliteti, ekonomik dhe mjedisor për këtë projekt? Nëse po, kërkohet akses në këtë dokument. • A është zhvilluar ndonjë konkurs publik ndërkombëtar për përzgjedhjen e këtij projekti dhe partnerit investues? • Nëse jo, mbi çfarë kriteresh është përzgjedhur partneri? • Cilat kompani kanë shprehur interes zyrtarisht për zhvillimin e portit? • Sa është pjesa e fitimit që i kalon shtetit shqiptar nga ky projekt? • A është realizuar një vlerësim i ndikimit në trashëgiminë kulturore dhe urbane të qytetit të Durrësit?	21.5.2025	Deleguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.	Deleguar	Nuk ka